

**Gjykata Themelore Ferizaj-Dega Kaçanik, Divizioni per Kundervajtje ,dhe ate gjyqtarja Zajrete Muhaxheri** me procesmbajtësen Indira Beqa , punetore e kesaj gjykate ,në lenden kundërvajtëse kundër të pandehurit Ibrahim Hoxha nga Kaçaniku , për shkak të kundërvajtjes nga neni 8 par 1 I sanksionuar me nenin 17 par 1.nenpar.1.1 te Ligjit per deklarimin ,prejardhjen dhe kontrollin e pasurise se zyrtareve te larte publik dhe deklarimin,prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave per te gjithë personat zyrtare ,e në baze të nenit 31,73,74,199 dhe nenit 9 të Ligjit për Kundërvajtje me dt. 28.10.2013 merr këtë;

## AKT V E N D I M

I pandehuri Ibrahim Selim Hoxha ,I lindur me dt.10.11.1962 ne Kaçanik ,ku edhe e ka vendbanimin , shqiptar, shtetas I Republikes se Kosoves,I martuar prind I kater femijeve ,ka te kryer fakultetin e ndertimtarise , keshilltar komunal ne Asamblene komunale ne Kaçanik ,I gjendjes së mesme ekonomike,

Ë sht ë për gj e gj ë s

Sepse si zyrtar I larte publik ne poziten e keshilltarit komunal ne Asamblene Komunale ne Kaçanik ,nuk e ka bere deklarimin e rregulli vjetor te pasurise prane Agjensise Kunder Korrupsionit deri me daten 31.03.2012.

Me qka ka kryer kundervajtje nga neni 8 par 1 I sanksionuar me nenin 17 par 1 nenpar.1.1 Ligjit per deklarimin ,prejardhjen dhe kontrollin e pasurise se zyrtareve te larte publik dhe deklarimin,prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave per te gjithë personat zyrtare

Andaj në bazë të nenit 31,73,74 dhe 199 të Ligjit për Kundërvajtje dhe nenit 17 par 1 nënpar.1 të Ligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë,

# D E N O H E T

**Me denim me gjobe në shumë prej 300 € (treqind euro), te cilin eshte e obliguar qe ta paguaj në afat prej 15(pesëmbëdhjete ) ditësh nga dita e plotfuqishmërise të këtij aktvendimi,në të kundërtën ,konform nenit 5 al.1 të Ligjit per kundërvajtje,dënimi me gjobë do t'i zevendesohet me denim me burg ashtu qe per qdo dite burgu do t'i llogariten nga 15 (Njëzet ) €**

Detyrohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve procedurale të paguaje pranë kësaj gjykate shumë prej prej 5.00 € ne emer te paushallit gjyqesor në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërise së këtij aktvendimi nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

mbaramit me dhunë.

REPUBLIC OF KOSOVO  
MINISTRY OF JUSTICE  
AGENCY FOR THE FIGHT AGAINST CORRUPTION  
AGENCIJA ZA BORBU PROTIV KORUPCIE

Case No. 03-3770/13  
Date 07.11.2013



## Arsyetim

Agjensia Kunder Korrupsionit ne Prishtine , ka parshtruar kërkesen per fillimin e procedures kundervajtese nr.01-2324/12 te dates 02.07.2012 , kunder te pandehurit Ibrahim Hoxha nga Kaçaniku ,per kundervajtje nga neni 5 ,6 dhe 9 i sanksionuar me nenin 17 par 1 nenpar.3 të Ligjit per deklarimin ,prejardhjen dhe kontrollin e pasurise se zyrtareve te larte publik dhe deklarimin,prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave per te gjithë personat zyrtare, dhe ka kerkuar qe I njejti te shpallet fajtor dhe te denohet sipas ligjit.

Ne baze te kerkeses se parshtruar I pandehuri eshte marre ne pyetje nga ana e gjykates me te cilin rast ka deklaruar se formulari i tij per deklarimin e pasurise i plotesuar eshte derguar tek zyrtari komunal per deklarimin e pasurise ,dhe se e sipas tij eshte neglizhuar dorezimi I formularit ne afatin e percaktuar me ligj ,por qe nuk ka patur per qellim qe t'I ik obligimit ligjor te deklarimit te pasurise .

Per vertetimin e plote te gjendjes faktike gjyqtarja ftoi ne cilesi te deshmitarit zyrtarin komunal Bejtullah Dalloshi ,I cili njeherit eshte autorizuar nga kryetari I komunes qe te sherbeje edhe si pike kontaktuese me Agjensine Kunder korrupsionit ,e I cili ne fjalen e yij deklaroi se ,lidhur me obligimin e deklarimit te pasurise te keshilltareve komunale dhe zyrtareve tjere te larte te parapare me ligj,te njejtit I ka njoftuar me kohe permes postes elektronike per qka para gjykates prezentoj njoftimin e dates 02.03.2012 drejtuar keshilltareve komunale permes e mailit zyrtar dhe privat ,dhe shton se perveq kesaj ka kerkuar edhe nga kryesuesi I kuvendit komunal qe ne mbledhjen e muajit mars 2012 qe t'I njoftoje te gjithë keshilltaret komunale per obligimin ligjor te deklarimit te pasurise deri me date 31.03.2012.me tutje cek se ne seancen e muajit mars keshilltari komunal Ibrahim Hoxha e kishte pyetur rreth obligimit te dorezimit te formulareve ne AKK-Prishtine ,ndersa me ate rast deshmitari I eshte pergjigjur se nuk ka obligim ligjor dorezimin e formulareve ne AKK- Prishtine.

Per t'u deklaruar rreth kualifikimit juridik te kundervajtjes ,gjyqtarja ftoi edhe perfaqesuesin e AKK,se ,ku me ate rast perfaqesuesi me autorizim I AKK,se Enis Sadiku deklaroi se, mbetet ne teresi prane kualifikimit juridik te kundervajtjes ,pasi qe sipas tij I pandehuri asnjehere me pare nuk e ka deklaruar pasurine e tij prane AKK,se ,gjersa ka qene ne poziten e keshilltarit komunal ,pasi qe kuptohet se edhe ligjerisht nuk ka patur obligim,e qe per kete arsye sipas tij nuk mund te konsiderohet se kemi te bejme me deklarimin e rregullt vjetor por me deklarimin sipas kerkeses se Agjensise .

Në bazë të dhënave si në kërkesë ,deklaratës së të pandehurit ,deklarates se perfaqesuesit me autorizim te AKK,se ne Prishtine dhe shkresave tjera te lendes , gjyqtarja konstatoi se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë elementet e veprës kundërvajtëse nga neni 8 par 1 I sanksionuar me nenin 17 par.1 nenpar.1.1 pasi qe me Ligjin nr.04/L-050 te gjithë keshilltaret komunale te Asambleve komunale jane perfshire ne listen e zyrtareve te larte qe njeherit edhe kane obligim deklarimin e rregullt vjetor prane AKK,se ne Prishtine,dhe per mandatin sa jane ne kete pozite kane per obligim deklarimin e rregullt vjetor te pasurise se tyre, dhe rrjedhimisht obligimi I deklarimit te pasurise del sipas ligjit, edhe nese agjensioni nuk kerkon deklarimin e pasurise.

Andaj gjykata duke u bazuar ne te theksuarat me larte ka bere rikualifikimin juridik te kundervajtjes dhe te pandehurin conform nenit 17 par.1 nenpar.1 e shpalli përgjegjës dhe e



dënoi me denim me gjobë në shumë prej 300 € (treqind euro) , te cilin është i obliguar që ta paguaje në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmerise se ketij aktvendimi ne te kunderten conform nenit 5 te LK,se dënimi me gjobë do t'i zevendesohet me denim me burg ashtu që për çdo ditë burgu do t'i llogariten nga 15 (pesëmbëdhjetë) € .

Gjykata me aplikimin e nenit 9 par.1 pika 1 te pandehurit I ka shqiptuar denim me gjobe nen masen minimale te denimit te percaktuar per kete kundervajtje,pasi që ka qene hera e pare per te pandehurin që si keshilltar komunal t'a deklaraje pasurine prane AKK,se ne Prishtine ,ndersa sa I perket vitit 2013 I njeiti e ka permbushur obligimin e deklarimit te pasurise Brenda afatit ligjor,qe do te thot se nuk e ka perseritur vepren e njejte kundervajtjese.

Me rastin e marrjes së aktvendimit konform nenit 7 të Ligjit për Kundërvajtje ,Gjykata mori parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese,kështu që si rrethanë lehtësuese gjykata mori faktin se I pandehuri është familjar prind I kater femijeve ,është hera e pare që e ka kryer kete kundervajtje ,dhe se nuk e ka perseritur vepren kundervajtjese, por ne vitin 2013 e ka deklaruar pasurine prane AKK,se Prishtine,ndersa rrethanë të posaqme rënduese gjykata nuk gjeti pos veprimeve të të pandehurit të cilat paraqesin elementet e veprës kundërvajtjese për të cilin është shpallur përgjegjës dhe është denuar si ne dispozitiv , duke vlerësuar se edhe me një denim të tillë do të arrihet efekti I sanksionimit ashtu që në të ardhmën I pandehuri t'u shmanget kryerjes së veprave të tilla apo të ngjashme kundërvajtjese.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është i bazuar në dispozitën e nenit 109 te Ligjit per Kundervajtje me të cilin rastë gjykata e detyroi të pandehurin që kësaj gjykate t'i përmbush shpenzimet e procedurës në emër të paushallit gjyqësor shumen prej 05.00 € duke pasur parasysh nderlikueshmerine e procedurës,gjendjen materiale të pandehurit,me bindjen se edhe nje denim i tille nuk do te ndikojë dukshëm në buxhetin familjar te te pandehurit.

**Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.**

**GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ  
DEGA NE KAÇANIK**

**R.I.nr.2120/2012 date 28.10.2013**

Sekretarja juridike,  
Indira Beqa



**Keshilla juridike:** Kunder ketij Aktvendimi i pandehuri  
Dhe parashtruesi I kërkesës mund te paraqesin ankesë  
në afatin prej 8 ditësh nga dita e pranimit ne  
Gjykatën E apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykate

Gjyqtarja  
Zajrete Muhaxheri

